



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 12,14 dhe 17 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, neneve 9 shkronja c), 17 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të dt.26.09.2008, dhe shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr.0204-1865/7 të dt.25.01.2016, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 03. 03. 2016, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratojë këtë:

VENDIM

**PËR ANULIMIN E PJESËRISHËM TË VENDIMIT 1NR.464-123 TË DT.20.06.2006
DHE SHKËPUTJEN E KONTRATËS 1-464-164 TË DT.01.08.2006 PËR
SHFRYTËZIMIN AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME**

Neni 1

ANULOHEM pjesërisht Vendimi 1Nr.464-123 dt.20.06.2006 i Kuvendit Komunal Lipjan për aprovimin e raportit të punës së komisionit për vlerësimin e konkursit publik për dhënie të tokës komunale në shfrytëzim afatgjatë në komunën e Lipjanit sipas ofertës numër 9272000906611 të datës 10.04.2006 dhe SHKËPUTET Kontrata 1-464-164 dt.01.08.2006 për shfrytëzimin afatgjatë prej 99 vitesh të pronës së paluajtshme, e lidhur në bazë të Vendimit 1Nr.464-123 dt.20.06.2006 ndërmjet komunës së Lipjanit e përfaqësuar nga ish Kryetari i Komunës Xhevat Olluri dhe ish menaxheri i prokurimit Shemsi Azemi (në tekstin e mëtejme-Komuna) si dhënës i tokës ndërtimore në shfrytëzim afatgjatë dhe shfrytëzuesit të tokës ndërtimore SH.P.K “BEN-AF” përfaqësuar nga Naim Kuqi (në tekstin e mëtejme-investitori) me seli në Suharekë, në ngastrat kadastrale si në vijim:
P-71409036-00164-20 në vendin e quajtur “Branjesh” me sipërfaqe prej 17643m², P-71409036-00166-7 në vendin e quajtur “Branesh” me sipërfaqe prej 12357m² të evidentuara në Certifikatën nr.4238/2015 ZK Konjuh, P.Sh.Kuvendi Komunal Lipjan shfrytëzues SH.P.K “BEN-AF”.

Neni 2

Anulimi i pjesërishtëm i Vendimit 1Nr.464-123 dt.20.06.2006 dhe shkëputja e Kontratës 1Nr.464-164 dt.01.08.2006 në bazë të nenit 10 par.10.1 dhe par.10.3, bëhet për arsye se shfrytëzuesi i tokës ndërtimore SH.P.K “BEN-AF” me seli në Suharekë nuk e ka përmbushur detyrimin kryesor për ndërtimin dhe funksionalizimin e objektit afarist “Qendër tregtare dhe fabrikë për prodhimin e produkteve nga brumërat dhe konservim i mishit” që rrjedhë nga neni 5 par.5.2 i kontratës, ndërsa në par.5.2.1 të nenit 5 përcaktohet se afati 3 vjeçar fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së lejës ndërtimore, ky afat 3 vjeçar sipas nenit 5 par.5.3 nënkupton edhe periudhën kur objekti duhet të lëshohet në përdorim dhe të fillojë veprimtaria afariste, ashtu siq ka qenë i obliguar me kontratë, dhe bazuar në nenin 11.par.11.4 Investitorit të cilit i shkëputet kontrata, Komuna nuk ia kthen pagesën e taksave sipas nenit 4 par 4.4 dhe par 4.5 të kontratës.

Neni 3

Me këtë Vendim obligohet shfrytëzuesi i tokës ndërtimore SH.P.K“BEN-AF” që në bazë detyrimeve kontraktore të cekura në par.11.3 të nenit 11 të kontratës 1-464-164 të dt.01.08.2006 që në afat prej 60 (gjashtëdhjetë) ditësh kalendarike nga dita e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të kthen ngastrat kadastrale në gjendjen e mëparshme.

Neni 4

Obligohet DGJK-Sektori për gjeodezi dhe kadastrë që të ndërmerr të gjitha veprimet procedurale për ndryshimin-marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të ngastrave kadastrale P-71409036-00164-20 në vendin e quajtur “Branjesh” me sipërfaqe prej 17643m² ZK Konjuh dhe P-71409036-00166-7 në vendin e quajtur “Branesh” me sipërfaqe prej 12357m² ZK Konjuh nga Sh.p.k ”Ben-af” dhe kthimin e tyre në librat publike P.SH KUVENDI KOMUNAL LIPJAN (siq ka qenë para dhënies së tokës në shfrytëzim).

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastrë, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati i Prokurimit dhe Drejtorati për Inspektion.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokolit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në webfaqen e Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi anulohet Vendimi 15Nr.464-61548 dt.21.12.2015 i Kuvendit të Komunës së Lipjanit për shkëputjen e kontratës 1nr.464-164 të dt.01.08.2006 e lidhur ndërmjet komunës së Lipjanit dhe shfrytëzuesit të tokës ndërtimore Sh.p.k”Ben-af” me seli në Suharekë.

15Nr. 464-11834
Lipjan, më 04. 03. 2016

KUVENDI I KOMUNËS SË LIPJAN

KRYESUESJA E KUVENDIT
Vlora Limani-Hajnuni

